**STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**«Lumière Clinic » SH.P. K**

# STATUT DHE AKT THEMELIMI
# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# «Lumière Clinic» SH.P. K

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Dispozita të zbatueshme dhe përkufizime

**1.1** Shoqëria **«Lumière Clinic » SH.P. K** themelohet dhe do të funksionojë në përputhje me legjislacionin tregtar dhe sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në këtë Statut.

**1.2** Në këtë Statut, termat e përdorur kanë kuptimin e mëposhtëm:
- "Ligji Tregtar" është Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ", i ndryshuar; çdo akt ligjor e nënligjor pjesë e legjislacionit tregtar;
- "QKB" është Qendra Kombëtare të Biznesit ;
- "Shoqëria" është **«Lumière Clinic» SH.P. K**
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë;
- "Ortakët" janë ortakët e Shoqërisë.

## KREU II
## EMRI, ORTAKËT, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA
### Neni 2
### Emri dhe Ortakët

**2.1** Shoqëria është e organizuar dhe funksionon sipas formës "shoqëri me përgjegjësi te kufizuar" dhe mban emrin **«Lumière Clinic» SH.P. K**

**2.2** Veprimtaria e Shoqërisë i nënshtrohet dispozitave të këtij Statuti si dhe legjislacionit të përmendur në Nenin 1.1.

**2.3** Ortakët e Shoqërisë janë:

**Znj.** ***JONA BETA*** e bija e Pellumb, e datëlindjes 12.09.1990, lindur në Tepelene e banuese në Tiranë në adresën "Osman Myderizi", shtetase shqiptare madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njohur prej meje noteres me Pasaportën Shqiptare **J05912055U**

**Znj.IRISI BETA**, e bija e Pellumb, e datëlindjes 20.07.1995, lindur në Tepelene e banuese në Tiranë në adresën "Osman Myderizi", shtetase shqiptare madhore,

**STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**«Lumière Clinic » SH.P. K**

me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njohur prej meje noteres me Pasaportën Shqiptare **J55720071S**

## Neni 3
## Objekti

**3.1** Qendër dermoestetike, sherbime mjeksore.
Shërbime në fushën e estetikës. Shitje e produkteve kozmetike dhe pajisjeve estetike.
Import, eksport te produkteve dhe pajisjeve kozmetike.

**3.2** Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Ortakët do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për përmbushur objektin e Shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.

## Neni 4
## Kohëzgjatja

**4.1** Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqeria mund të prishet ne cdo kohë me nje vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Ortakeve, në perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## Neni 5
## Selia

**5.1** Shoqëria do ta ketë selinë e saj në adresën e mëposhtme : **Rruga Skender Luarasi, Kati 1 , Ap 1, Njesia Administrative Nr 9, 1016, Tirane.**

**5.2** Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe sipas juridiksionit të vendit përkatës.

# KREU III
# VLERA DHE SHLYERJA E KAPITALIT TË REGJISTRUAR

## Neni 6
## Vlera dhe shlyerja e kapitalit te regjistruar

**6.1** Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë (nje qind mije lekë) dhe konsiston në 2(dy) kuota. Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

**6.2** Pjesëmarrja e Ortakëve në shoqëri është në raport me kontributet e tyre dhe vlera nominale e kuotës së secilit Ortak llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emri i Ortakut | Kuota | Vlera (lekë) | Kapitali (%) |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Znj. JONA BETA | 50 | 50,000 lekë | 50 % |
| 2. | Znj.IRISI BETA | 50 | 50,000 lekë | 50 % |
| TOTALI | | 100 | 100,000 lekë | 100 % |

**6.3** Kapitali është nënshkruar dhe shlyer plotesisht nga Ortakët.

### Neni 7
### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

**7.1** Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me anë të kontributeve në para dhe/ose në natyre në përputhje me Ligjin Tregtar.

**7.2** Vendimet e Shoqërisë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit i merr Asambleja e Përgjithshme.

## KREU IV
## KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

### Neni 8
### Fitimi dhe kalimi i kuotave

**8.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) shitblerjes;
c) trashëgimisë;
d) dhurimit;
e) cdo mënyre tjetër të parashikuar në Ligjin Tregtar.

**8.2** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

**8.3** Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë e kontratës.

**8.4** Shoqëria e regjistron kalimin e kuotës në QKB në përputhje me Ligjin Tregtar.

## KREU V
## ORGANI VENDIMMARRËS

### Neni 9
### Asambleja e Përgjithshme

**9.1** Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, që është organi përgjegjës për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
b) ndryshimet e Statutit;
c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
i) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar apo ky Statut.

### Neni 10
### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

**10.1** Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga Ligji Tregtar dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit nga administratorët apo ortakët në përputhje me Ligjin Tregtar.

**10.2** Asambleja e Përgjithshme thirret domosdoshmërisht, nëse:

**10.2.1** Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

**10.2.2** Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të

cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

**10.2.3** Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të Shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

**10.3** Asambleja e Përgjithshme cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin. Nëse Administratori i pranishëm nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes, ose nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme zgjedh si Kryetar të mbledhjes njërin prej ortakëve të pranishëm.

**10.4** Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme, të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, duke marrë parasysh që në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kryetari është i detyruar ta shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëse këtë e kërkon Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 11
## Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

**11.1** Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

**11.2** Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 11.1, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 12
## Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

**12.1** Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

**12.2** Administratorët e Shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

**12.3** Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të Asamblesë së

Përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 13
## Kuorumi

**13.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në mbledhjen e saj marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, siç përcaktohet në Ligjin Tregtar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

**13.2** Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 13.1, Asambleja e Përgjithshme mblidhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.Ne qofte se edhe heren e dyte mbledhje e asambles deshtonper mungese kurumi atehere brenda 30 ditesh thirret e trete me te njejtin rend dite e cila mund te mblidhet me nje kurum me pak se 51% e kuotave.

## Neni 14
## Marrja e vendimeve

**14.1** Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

**14.2** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligjin Tregtar, për çështjet e tjera të renditura në nenin 9 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.Ne rast se rezultati i volumit eshte 50% me 50%,ateheer vendimi merret me short.

**14.3** Kryetari i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme deklaron nëse vendimi është marrë në mënyrë unanime apo me një shumicë të caktuar, të cilësuar apo të zakonshme, apo nëse nuk është miratuar, dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit. Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, nga cilido ortak, do të zhvillohet edhe një votim tjeter për përcaktimin e numrit te votave pro dhe kundër vendimit.

## Neni 15
## E drejta e votës

**15.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, në përputhje me Ligjin Tregtar.

**15.2** Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

**15.3** Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në, të mëposhtmet:
a) transmetimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në kohë reale;
b) komunikimin e ndërsjelltë në kohë reale, që u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, pa qenë nevoja që të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

**15.4** Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve që të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronike kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

**15.5** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

**15.6** Ortakët kanë të drejtën për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

## Neni 16
## Përjashtimi nga e drejta e votës

**16.1** Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;

ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

**16.2** Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 17
## Procesverbalet e mbledhjes

**17.1** Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

**17.2** Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

**17.3** Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

**17.4** Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

# KREU VI
# ORGANI DREJTUES

## Neni 18
## Administratori

**18.1** Organi drejtues i Shoqërisë është Administratori, **Z.JONA BETA**, atësia PELLUMB, e datëlindjes 12.09.1990, lindur në Tepelene e banuese në Tiranë në adresën Osman Myderizi , shtetase shqiptare , madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njohur prej meje noteres me Pasaportën Shqiptare **J05912055U**, që emërohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Organi drejtues i Shoqërisë është Administratori, **Znj.IRISI BETA**, atesia Pellumb, e datëlindjes 20.07.1995, lindur në Tepelene e banuese në Tiranë në adresën "Osman Myderizi", shtetase shqiptare madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njohur prej meje noteres me Pasaportën Shqiptare **J55720071S,** që emërohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

**18.2** Emërimi i Administratorit të Shoqërisë u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të Ligjit Tregtar.

**18.3** Shpërblimi bazë i Administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme. Këtij shpërblimi mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.

**18.4** Asambleja e Përgjithshme mund ta shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## Neni 19
## Kompetencat e Administratorit

**19.1** Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë. Administratori, ka të drejtën e pjesëmarrjes, si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

**19.2** Administratori, specifikisht, ka të drejtë dhe detyrohet të:

i. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
ii. përfaqësojë Shoqërinë;
iii. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të Shoqërisë ;
iv. nënshkruajë çdo marrëveshje dhe çdo transaksion per shlyerjen e detyrimeve ndaj te treteve jo me shume se 100,000 euro per transaksion;
v. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
vi. krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
vii. kryejë regjistrimet dhe njoftojë/regjistrojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, në përputhje me Ligjin Tregtar;
viii. marrë në punë, emërojë dhe shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, perfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjentë, si dhe të percaktojë kompetencat dhe detyrat e të punësuarve;
ix. raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
x. pregatise dhe te zbatoje te gjitha planet per zhvillimin e aktivitetit vjetor
xi. kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin Tregtar.

**19.3** Administratori nuk mund të autorizojë një të tretë, sipas parashikimeve të ligjit tregtar, për kryerjen e të gjitha kompetencave të përshkruara në këtë nen si dhe për ato kompetenca që i lindin në bazë të Ligjit Tregtar.

**Neni 20**

**Kufizimet ne veprimet e administratorit**

**20.1** Administratori nuk do te lidhe marreveshje per ceshtje ne te cilin ai ka, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundershtim me interesat e Shoqerise, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithe anetaret kane rene dakord qe te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshjeje.

**20.2** Autorizimi paraprak dhe i përgjithshëm, referuar pikes 20.1, jepet nga të gjithë ortakët ose të gjithë ortakët e tjerë të Shoqërisë dhe njoftohet për regjistrim në QKB.

**KREU VII**

**SISTEMI FINANCIAR DHE KONTABËL**

**Neni 21**

**Kontabiliteti, Viti Financiar**

**21.1** Sistemi financiar dhe kontabël i Shoqërisë do të zbatojë të gjitha kërkesat e sistemit ligjor shqiptar financiar dhe kontabël.

**21.2** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor të po të njëjtit vit.

**Neni 22**

**Ekspertët kontabël të autorizuar**

**22.1** Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

**22.2** Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike-tregtare të Shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur është ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme.

**22.3** Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të raportit vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Asamblesë së

Përgjithshme për t'i shqyrtuar dhe miratuar mbi bazën e të drejtës së saj vendimmarrëse.

## KREU VIII
## PRISHJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 23
### Prishja dhe likujdimi

**23.1** Shoqëria prishet, në rastet e mëposhtme:
a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të Shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara Ligji Tregtar;
d) në raste të tjera, të parashikuara nga Ligji Tregtar;
dh) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.

**23.2** Prishja e Shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d" dhe "dh" të pikës 14.1, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e parashikuar nga Ligji Tregtar.

**23.3** Në rast mosveprimi të Asamblesë së Përgjithshme për të vendosur prishjen për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c" dhe "d" të pikës 14.1, çdo person i interesuar mund që, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e Shoqërisë.

**23.4** Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara në shkronjat "a", "c", "d" dhe "dh" të pikës 14.1, nuk do të ketë si pasojë prishjen e Shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 14.3, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga Shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

**23.5** Prishja e Shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 14.1, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e Shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së Shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

**23.6** Prishja e Shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 14.1, vendoset nga gjykata kompetente sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

**23.7** Në rast se Shoqëria kalon në proces likuidimi, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos, mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e parregullsisë të punës së likuiduesit dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

**23.8** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate, rast në të është gjykata ajo që i dergon njoftimin QKB-së.

## KREU IX
## E DREJTA E INFORMIMIT, NJOFTIMET
### Neni 24
### Njoftimet dhe publikimi

**24.1** Njoftimet e kryera nga çdo person, sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose, nëse zbatohet, nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e Shoqërisë, dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe për personin që kryen njoftimin.

**24.2** Ky Statut, së bashku me ndryshimet, si dhe të gjitha dokumentet e Shoqërisë që përfshijnë, por pa u kufizuar në, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë, komunikimet, si dhe raportet e organit drejtues ose të ekspertëve kontabël të autorizuar, duke përjashtuar informacionin e klasifikuar si sekret tregtar, do të publikohen nga Administratori në faqen e internetit të Shoqërisë (nëse zbatohet), në përputhje me Ligjin Tregtar. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion nga Administratori për të gjithë ortakët e Shoqërisë, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të Shoqërisë.

## KREU X
## SHNDËRRIMI I SHOQËRISË
### Neni 25
### Procedura dhe pasojat e Shndërrimit

**25.1** Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shndërrimit, sipas procedurës së parashikuar në Ligjin Tregtar. Vendimi për shndërrimin e Shoqërisë merret nga Asambleja e Përgjithshme, me një shumicë prej tre të katërtave.

**25.2** Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Marrëdhëniet e brendshme në fushën e menaxhimit dhe administrimit të Shoqërisë midis administratorit, Asamblesë së Përgjithshme, dhe çdo të punësuari në Shoqëri, do të rregullohen me anën e një rregulloreje të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

**25.3** Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Tregtar, së bashku me vendimin e shndërrimit dhe procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme për miratimin e tij.

## KREU XI
## DISPOZITA TË FUNDIT
### Neni 26
### Të Ndryshme

**26.1** Çdo dokument që lëshohet për, dhe në emër te Shoqërisë, mban vulën e saj.

**26.2** Të gjitha marrëdheniet e punës në Shoqëri do të rregullohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor të zbatueshëm.

**26.3** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e Statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

**26.4** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor të zbatueshëm.

**26.5** Veprimtaria e Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të saj në QKB.

**26.6** Ky Statut nënshkruhet sot, më datë 03.04.2023, në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**Emri dhe nënshkrimi:**

***ORTAKET***

| | |
|---|---|
| **JONA BETA** | **IRISI BETA** |
| Jona Beta | Irisi Beta |